



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI I QARKUT KUKES**



**VENDIM**

Nr. 31 Date 20.09.2013

**PER NGRITJEN E AGJENSISE RAJONALE TE ZHVILLIMIT TE QARKUT KUKES**

Keshilli i Qarkut Kukës ne mbledhjen e tij te dates se mesiperme, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Hartimit dhe Koordinimit te Projekteve, bazuar ne ligjin Nr.8652 date 31.07.2000 "Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore, neni 54 pika "dh" me propozimin e Kryetarit te Keshillit te Qarkut Kukës

**VENDOSI:**

1. Te miratoje krijimin e Agjensise Rajonale te Zhvillimit te Qarkut Kukës si ent publik me personalitet juridik ne varesi te Keshillit te Qarkut Kukës, me seli ne Kukës. Regjistrimi i saj ne gjykate te behet brenda afatit kohor.
2. Agjensia Rajonale e Zhvillimit Kukës ka si objekt te veprimtarise se saj te jete katalizator dhe koordinues per te gjitha projektet zhvillimore per zbatimin e strategjise se zhvillimit rajonal; te zhvilloje kapacitetet institucionale drejt menaxhimit te proceseve te zhvillimit ekonomik; te mbeshtese rigjenerimin ekonomik; te promovoje punesimin dhe te zgjeroje aplikimin e aftesive qe jane relevante per punesim.
3. Agjensia Rajonale e Zhvillimit Kukës ka këto detyra:
  - Koordinimin Rajonal dhe te marrëdhënieve ndër-institucionale
  - Hartimin dhe zbatimin e Strategjive te zhvillimit rajonal
  - Hartimin e projekteve ne te gjitha fushat e zhvillimit Rajonal
  - Menaxhimin dhe Implementimin e Programeve te Zhvillimit Rajonal
  - Nxitjen dhe mbeshtetjen e iniciativave te aktoreve lokale
  - Transferimin e Teknologjive dhe Inovacioneve në Rajon
4. Agjensia Rajonale e Zhvillimit Kukës, për shërbimet që ofron, financohet nga Buxheti i Qarkut Kukës, nga projekte të ndryshme, nga institucione të huaja si dhe nga burime të tjera të ligjshme.
5. Struktura, organika dhe funksionimi i Agjencisë Rajonale te Zhvillimit Kukës përcaktohen në statut rregulloren e kësaj agjensie, e cila miratohet me vendim te Keshillit te Qarkut Kukës.
6. Emërimi, lirimi dhe shkarkimi nga detyra i drejtuesit të Agjencisë Rajonale te Zhvillimit Kukës bëhen me urdhër të Kryetarit te Qarkut Kukës.
7. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjensie rregullohen sipas dispozitave ligjore dhe nenligjore ne fuqi.





# REPUBLIKA E SHQIPERISE KESHILLI I QARKUT KUKES





8. Buxheti per kostot operacionale për vitin e pare te krijimit për këtë Agjensi do të përballohet nga fondi i Keshillit te Qarkut Kukës.
9. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari, Sekretari i Keshillit te Qarkut Kukës, Drejtoria e HKP si dhe Zyra e Finances.
10. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETARI**

**Ibsen ELEZI**



**Konc:** I.Shahu   
**Ligjshmeria:** G.Çejku   
**Sekretari:** B.Ngjeçi

U hartua ne 4 (kater) kopje origjinale:

1. Zyres se Protokoll Arkivit ✓
2. Prefektit te Qarkut Kukës ✓
3. Drejtorise se HKP-se